



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
GLAVNI CENTAR PORODIČNE MEDICINE • MAIN FAMILY HEALTH CENTRE
"Dr. Shaban Geci" KAMENICË

Datë: 20.11.2020

Në bazë të nenit 8,10 parag. 2.1 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, nenit 67 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, si dhe Vendimit mbi aprovimin për shpallje të Konkursit të lëshuar nga Kryetari i Komunës Sh.02 Nr.27391 i datës: 20.11.2020, Drejtori i QKMF-së shpallë këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në QKMF- Kamenicë

Titulli i pozitës : Mjek i Përgjithshëm

Nr. i ekzekutuesve: pesë (5) ekzekutues/e

Orar i punës: 40 orë në javë

Koeficienti: H,-27 / Gr/Str. 565 €

Lloji i kontratës: Kontratë në kohë të Pacaktuar

Vendi i Punës: Qendra Kryesore e Mjeksisë Familjare- Kamenicë

Mbikëqyrësi: Drejtori i QKMF-së

Detyrat Kryesore:

Ofron Shërbime me standard të lartë bazuar në mjekësinë e bazuar në dëshmi;

Ofron shërbime gjithëpërfshirëse për individin/pacientin

Përcakton diagnozë diferenciale dhe diagnozën e punës në përputhje me simptomatologjinë;

Përcjellja sistematike e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve dhe adoleshentëve;

Kujdesi për personat e moshuar dhe në nevojë;

Ofron kujdes për rastet urgjente dhe i referon rastet me kohë dhe në mënyrë adekuate;

Interpreton rezultatet e testeve të shpejta laboratorike;

Komunikon ose konsultohet me specialist të Mjekësisë Familjare sipas nevojës;

Referon pacientët te specialisti dhe për kujdesë spitalor;

Kujdesi i vazhdueshëm për pacientët me sëmundje kronike jo ngjitëse;

Kontrolli i sëmundjeve ngjitëse (hulumtimet epidemiologjike);

Promovimi shëndetësor dhe parandalimi i sëmundjeve si dhe shërbimet në komunitete (vendet rurale, Shkolla, komunitete);

Zbatimi i programit të vaksinimit, Edukim shëndetësor etj.

Shkollimi/Kushtet dhe Kriteret:

Fakulteti i Mjekësisë - Drejtimi i Përgjithshëm/Doktor i Mjekësisë/

Diploma / e noterizuar

Licensa e Punës/e noterizuar

Certifikata Shëndetësore

Përvoja e punës: e dëshirueshme

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartëcekur duhet t'i komplettoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (kopje) si vijon :

Dëshmi të kualifikimit shkollorë

Licensa e punës

Dëshmi mbi përvojën e punës (nëse ka)

Dokumentin e identifikimit

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Kamenicë.

Afati i aplikimit është 15 ditë, nga dita e shpalljes të konkursit në Web faqen komunale dhe tabelën e shpalljeve.

Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët e përfshirë në listën e ngushtë mbi bazën e kriterëve të konkursit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

Intervista do të mbahet me shkrim dhe me gojë (Verbale).

